



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në ankesën e

AC-I-22-0592-A0001

Paditësi

N H, i përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

kundër

E paditura/Ankues

N.SH IMN "KOSOVA" (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1203 të datës 04 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Reformulohet ex officio pika 2 e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-IV-15-1203 i dt. 04 tetor 2022, ashtu që do të jetë teksti "Obligohet e paditura AKP që paditësit N H në emër të kompensimit për 19 paga të papaguara, për periudhën 2009-2011, ti paguaj shumën prej 1,615,00 euro, dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumes themelore, ti paguaj shumën prej 161.50 euro".**

3. Vërtetohet pika 1, 3 dhe 4 e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-IV-15-1203 i dt. 04 tetor 2022.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 25 qershor 2015, paditësi e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PRN029-0056 të datës 26 maj 2015, me të cilin Autoriteti i Likuidimit, kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompensim e pagave të pa paguara për periudhën qershor 2007 deri në janar 2011, në shumë prej 1.615,00 euro, me arsyetimin se kërkesa për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Autoriteti i Likuidimit po ashtu kishte konstatuar se paditësi me datë 25 janar 2011, e ka dorëzuar një Propozim për ekzekutim E.88/2011, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, mirëpo ky propozim nuk është aprovuar pasi që nuk ishte i bazuar në një vendim të Gjykatës të formës së prerë, andaj nuk është caktuar ndonjë detyrim për ndërmarrjen lidhur me kompensimin e pagave. Paditësi në ankesë ka pohuar se këto gjetje faktike dhe konstatime të Autoritetit të Likuidimit janë të gabuara, pasi që nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës lidhur me këto paga. Ai pohon se pas fillimit të procedurës së likuidimit është paraqit një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit që të kompensohen këto paga, por e cila pa ndonjë bazë është refuzuar. Paditësi me ankesë kërkon që të detyrohet e padatuara që paditësit t'ia kompensoj pagat e papaguara për periudhën 2009 deri 2011, në shume prej 1,615.00 euro. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar një librezën e punës, një kontratë pune për kohe ta pacaktuara, e protokolluar me nr. 82/12 dt. 20 gusht 2012, një kopje të Propozimit për përmbarrim që ishte dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 25 janar 2011, bazuar në dokumentacionin autentik të NSH-së "IMN Kosova", regjistrin e punëtorëve që e kishin parashtruar këtë propozim, njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës dt. 23 qershor 2014, dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, autorizimin për përfaqësim si dhe kopjen e letërnjoftimit.

Me 08 shtator 2017, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë

vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të theksoi në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se ky Vendim nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore, prandaj nuk ka bazë të shfuqizohet. AKP-ja pohon se kërkesa për paga për periudhën 2009 - 2011 është parashkruar pasi që propozimi për ekzekutim E.nr.88/2011 i datës 25 janar 2011, është paraqitur pasi kanë kaluar 3 vite, andaj kjo kërkesë në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar konsiderohet e parashkruar. Në mbrojtje në ankesë AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me 04 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-15-1203, e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar dhe e detyron AKP-në që në emër të pagave të papaguara, për përudhën 2007- 2009, ti paguaj paditësit shumën prej 1,615,00 euro, në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, ti paguaj shumën prej 161.50 euro si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumën 124,00 euro. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa e paditësit për pagesën e pagave nuk është parashkruar, pasi që propozimi për përmbarim i paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 25 janar 2011, e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit. Tutje Shkalla e I-rë e DHPGJS-së konstaton se nuk është kontestuese fakti se në mes palëve ankuesi ishte punëtor i NSH "IMN Kosova" në Prishtinë dhe se ai kishte ofruara shërbime pune për periudhën 2009-2011 dhe se ky fakt është konstatuar me prova relevante siç janë librezat e punës dhe regjistri i punëtorëve. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se ajo është parashkruar, mirëpo ky konstatim siç u tha nuk është i bazuar. Me rastin e aprovimit të shumës prej 1,615,00 euro është marre për bazë paga minimale e cila ka qenë në kohën e krijimit të detyrimit të NSH-se ndaj paditësit, duke u bazuar në pagën minimale prej 85 euro (19 paga x 85 euro = 1,615 euro), paditësit i takon shuma e kompensimit në emër të pagave prej 1,615 euro. Shkalla e I-rë po ashtu paditësit i ka njohura të drejtën e interesit ligjor prej 10 % në shumën prej 161.50 euro konform nenit 37.3 të shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, e cila do të përmbushet sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave në

procedurë të Likuidimit. Gjithashtu në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për DHPGJS paditësit i janë njohur shpenzimet e procedurës në shumën 124,00 euro.

Me 21 tetor 2022, për mes postës AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-1203 të datës 04 tetor 2022, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, dhe të refuzohet ankesa e paditësit e të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankese AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të sakte të rrethanave faktike dhe se në mënyrë të drejte ka zbatuar të drejtën materiale. AKP-ja pretendon se paditësi nuk ishte punëtor aktiv në momentin kur ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së, andaj nuk ka asnjë detyrim financiar NSH-ja ndaj paditësit. AKP-ja pretendon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës është një njoftim shabllon dhe ky njoftim u dërgohet të gjitha kreditorëve të mundshëm për ti lajmuar se NSH-ja ka hyrë në likuidim dhe se mund të dorëzojnë kërkesa të pretenduar ndaj NSH-se. Ky njoftim nuk nënkupton ndonjë detyrim të NSH-se dhe as pranim të ndonjë borxhi të pretenduar ndaj NSH-se. Tutje AKP-ja pretendon se aktgjykimi i ankimuar e ka shkelur nenin 54 të LDHP-së pasi që ky aktgjykim nuk i përmban të gjitha detyrimet të përcaktuar me këtë dispozite lidhur me nevojën e analizës së provave. AKP-ja kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtohet edhe njëherë meritat e ankesës dhe të merren në konsideratë argumentet e ngritura nga ana e autoritetit të likuidimit.

Me 20 dhjetor 2023, paditësi e dorëzoj në DHPGJS një përgjigje në ankesën e AKP-se. Me këtë përgjigje paditësi i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të AKP-së dhe e mbështet aktgjykimin e ankimuar të shkallës së parë të DHPGJS-së duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj. Tutje në këtë parashtrëse paditësi pohon se AKP-ja vetëm i ka përsërit argumentet e saja ligjore që nuk janë marrë në konsideratë nga ana e Gjykatës, nuk ka paraqitur ndonjë argument dhe prove të re që do të vlente dhe të merret në konsiderim. Në këtë parashtrëse paditësi ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të

refuzohet ankesa e AKP-se si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet, megjithatë Riformulohet ex officio pika 2 e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-IV-15-1203 i dt. 04 tetor 2022, ashtu që do të jetë teksti "Obligohet e paditura AKP që paditësit N H në emër të kompensimit për 19 paga të papaguara, për periudhën 2009-2011, ti paguaj shumën prej 1,615,00 euro, dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumes themelore, ti paguaj shumën prej 161.50 euro".

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 08 korrik 2014, për kompensimin e 19 pagave të pa paguara në shumë prej 1,615.00 euro nga NSH "IMN Kosova" i përket periudhës 2009-2011. Kjo nuk është kontestuese sepse edhe paditësi në ankesën e parashtruar kundër vendimit të AL, por edhe e paditura AKP përmes mbrojtjes të parashtruar në ankesë i është referuar periudhës së njëjtë kohore. Po ashtu vërehet se Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se kjo kërkesë është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për pagat e paditësit është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë e kishte bashkangjitur një Propozim për përmbarrim në bazë të dokumentacionit autentik të debitorit NSH "IMN Kosova" në Prishtinë, i cili ishte dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 25 janar 2011. Duke u bazuar në këtë provë, të cilën e ka pas parasysh edhe Shkalla e I-rë edhe Autoriteti i Likuidimit, Kolegji i Apelit konstaton se kërkesa për kompensimin e këtyre pagave nuk është parashkruar për periudhën, 2009-2011. Pagat e kësaj periudhe kohore nuk mund të konsiderohen si të parashkruara, pasi që paditësi ka marrë veprime ligjore, e ka paraqitur Propozimin për Përmbarrim në bazë të dokumentacionit autentik brenda 3 viteve. Nuk është relevant në këtë rast rezultati i dhënë negativ për paditësin nga Gjykata Komunale në Prishtinë lidhur me Propozimin për Përmbarrim që e kishte paraqitur ai, sipas të cilës bazë po ashtu Autoriteti i Likuidimit e mbështet refuzimin e kërkesës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi e ka dorëzuar Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 23 qershor 2014, kontratën e punës dt. 20 gusht 2012 dhe librezën e punës, sipas secilës vërtetohet se paditësi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 23 qershor 2014, kur NSH ka shkuar në likuidim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ka pohuar se paga mujore e tij për periudhën 2009 e deri 2011, ka qenë 85 euro, dhe kjo gjë është vërtetuar me regjistrin e punëtorëve të nënshkruar nga zyrtaret përgjegjës të NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të dëshmive të ofruar nga paditësi, Shkalla e I-re e DHPGJS-se me të drejte e kishte aprovuar ankesën e paditësit dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të autoritetit të likuidimit, duke ia njohur paditësit 19 paga të papaguara për periudhën që ende nuk ishte parashkruar, përkatësisht për periudhën 2009-2011, në shumën prej 1,615.00 euro, e cila duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në procedurën e Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë në pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar kur i referohet periudhës për paga në vend që të shënoj periudhën 2009-2011 ka shënuar 2007-2009, prandaj Kolegji i Apelit ex officio e

riformulon vetëm pikën 2 të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-15-1203 të dt. 04 tetor 2022, ndërsa pikët tjera të dispozitivit 1, 3 dhe 4 të Aktgjykimit vërtetohen.

Prandaj nga këto arsyeje refuzohet ankesa e AKP-se si e pabazuar dhe vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro me datë 29 nëntor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 07 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____